



**Mali i Zi / Crna Gora**  
**Komuna e Tuzit / Opština Tuzi**

**Sekretariati për bujqësi, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe administrimin e ujërave**  
Sekretariat za poljoprivredu, zaštitu životne sredine i vodoprivredu

Nr./Br. 06-317/26-4691/19

**Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44**  
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167

agrotuzi@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 19.06.2026. godine

Na osnovu člana 4 stav e Odluke o podsticajima i investiranju u razvoj poljoprivrede Opštine Tuzi ("Službeni list Crne Gore - opštinski propisi", br. 20/23) kao i Programa mjera za realizaciju sredstava za razvoj poljoprivredne proizvodnje u Opštini Tuzi za 2026. godinu – Agrobudžet ("Službeni list Crne Gore - opštinski propisi", br. 26/26), Sekretariat za poljoprivredu, zaštitu životne sredine i vodoprivredu **objavljuje**

## **JAVNI POZIV ZA DIREKTNIA PLAĆANJA U BILJNOJ PROIZVODNJI ZA 2026. GODINU**

### **I VRSTA PODSTICAJA**

Podrška se odnosi na poljoprivredne proizvođače sa područja opštine Tuzi koji djelatnost ostvaruju na teritoriji opštine Tuzi, tj nosiocima poljoprivrednih gazdinstava.  
Ova mjera se realizuje kroz podršku po jedinici površine (ha), tj. obrađene površine pod jednogodišnjim, višegodišnjim zasadima, dekorativnog i aromatičnog bilja, povrća i ratarskih kultura.

### **II VISINA PODRŠKE**

Visina podrške će zavistiti od raspoloživih sredstava opredijeljenih za ovu mjeru, površine pod povrćem, ratarskim, kulturama, višegodišnjim zasadima, dekorativnog i aromatičnog bilja.

Podrška će iznositi do 500 eura po hektaru obradive površine, tj. površine pod jednogodišnjim, višegodišnjim zasadima, dekorativnog i aromatičnog bilja, povrćem i ratarskim kulturama. Obradiva površina je oranica sa poljoprivrednom kulturom, na otvorenom, plasteniku pod višegodišnjom kulturom. Podrška poljoprivrednom proizvođaču za prvi hektar će iznositi do 500 eura dok će za svaki sledeći hektar iznos podrške iznositi do 300 eura/ha.

Maksimalan iznos podrške po poljoprivrednom gazdinstvu će biti do 5.000,00 €. Ako ukupna visina svih zahtjeva za dodjelu podrške po ovom javnom pozivu, prevazilazi budžetom planirana sredstva, proporcionalno će se smanjiti iznos podrške do visine planiranih sredstava. Za ovu mjeru je Agrobudžetom predviđen iznos od 295.500,00 €.

### **III KORISNICI SREDSTAVA**

Korisnici sredstava podrške, po ovom Javnom pozivu, su poljoprivredna gazdinstva i poljoprivredni proizvođači sa područja opštine Tuzi koji svoju djelatnost ostvaruju na teritoriji naše opštine, upisana do trenutka podnošenja Zahtjeva za dodjelu podrške u:

- Registar poljoprivrednih gazdinstava, u skladu sa Zakonom o poljoprivredi i ruralnom razvoju („Službeni list CG“, br. 34/14, 1/15, 30/17, 51/17 i 59/21) i Pravilnikom o obliku i načinu vođenja registra subjekata i registra poljoprivrednih gazdinstava („Službeni list CG“, broj 16/14 i 37/18), koje vodi Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i vodoprivrede i u registar koji vodi Uprava za bezbjednost hrane, veterinu i fitosanitarne poslove ili
- Registar primarnih proizvođača hrane biljnog porijekla u skladu sa Zakonom o bezbjednosti hrane („Službeni list CG“, broj 57/15) ili
- Ukoliko su podnosioci zahtjeva u statusu pravnih lica, neophodno je da im je primarna djelatnost iz Sektora A: poljoprivreda, šumarstvo i ribarstvo, u skladu sa Zakonom o klasifikaciji djelatnosti („Službeni list CG“, broj 18/11).

### **IV PROCEDURA REALIZACIJE I AKTIVNOSTI**

Podrška se obezbjeđuje za sva poljoprivredna gazdinstva za obradive površine, tj. površine pod jednogodišnjim, višegodišnjim zasadima, dekorativnim i aromatičnim biljem, povrćem i ratarskim kulturama.

Aktivnosti koje se odnose na ovu mjeru su:

- Poljoprivredni proizvođač se obraća Sekretarijatu zahtjevom za dodjelu podrške po hektaru za jednogodišnje, višegodišnje zasade, dekorativnog i aromatičnog bilja, povrća i ratarskih kultura za 2026. godinu (OBRAZAC 1) sa pratećom dokumentacijom
- Prijem zahtjeva i potrebne dokumentacije;
- Operativni terenski rad (praćenje proizvodnje);
- Obrada zahtjeva;
- Isplata premija na žiro račun podnosioca zahtjeva.

#### V POTREBNA DOKUMENTACIJA

Popunjen Zahtjev za dodjelu podrške u biljnoj proizvodnji 2026. godinu (koji je sastavni dio ovog Javnog poziva);

- Dokaz da su registrovani kod Ministarstva poljoprivrede šumarstva i vodoprivrede,
- Zahtjev za dodjelu podrške za direktna plaćanja u Ministarstvo poljoprivrede šumarstva i vodoprivrede (SIZEP)
- Fotokopija lične karte
- Fotokopija tekućeg računa

#### VI NAČIN PODNOŠENJA ZAHTJEVA ZA DODJELU PODRŠKE

Obrazac Zahtjeva za dodjelu podrške za direktna u biljnoj proizvodnji za 2026. Godinu (PRILOG I) može se preuzeti sa internet stranice Opštine Tuzi ([www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me)) i u kancelariji Sekretarijata za poljoprivredu, zaštitu životne sredine i vodoprivredu.

Popunjen obrazac zahtjeva za dodjelu u biljnoj proizvodnji za 2026. Godinu sa pratećom dokumentacijom dostaviti arhivi Opštine Tuzi.

Informacije u vezi sa ovim javnim pozivom mogu se dobiti putem telefona: 020/ 875 167; 067/ 179 - 284 i 067/ 083 - 367 i putem email adrese: [agrotuzi@tuzi.org.me](mailto:agrotuzi@tuzi.org.me)

**Trajanje Javnog poziva je od 19. juna 2026. do 28. avgusta 2026 godine.**

Obrada primljenih Zahtjeva će se vršiti u toku trajanja javnog poziva dok će se plaćanje vršiti nakon završetka javnog poziva, a najkasnije do kraja kalendarske godine.

#### VII NAPOMENE

Podnosilac zahtjeva odgovara za tačnost podataka i dokumentacije za ostvarivanje prava na podršku. Sekretarijat za poljoprivredu, zaštitu životne sredine i vodoprivredu zadržava pravo da, prije isplate, izvrši provjeru realnosti i osnovanosti ucrtanih parcela. U slučaju otkrivanja nepravilnosti u zahtjevu aplikantata koji netačno prijave podatke ili otkrivanja drugih zloupotreba u ovoj mjeri podrške, ima pravo donijeti rešenje da ti korisnici neće moći da koriste mjere podrške poljoprivrednoj proizvodnji koje daje opština Tuzi u ovoj i drugim mjerama podrške u periodu od dvije naredne godine (2027-2028), osim u slučaju više sile. Viša sila je prirodni događaj ili ljudska radnja koja se nije mogla predvidjeti ili spriječiti, a usljed kojih je nastupila šteta, s tim da se ljudska radnja nije mogla pripisati u krivicu lica na koje bi inače pripala odgovornost. U slučaju da podnosilac zahtjeva ne dozvoli ili spriječi kontrolu, ili na bilo koji način utiče na nju podneseni zahtjev će biti odbijen.

Nepotpuna i neblagovremeno podnijeta dokumentacija se neće razmatrati.



**MB SEKRETAR,**

**Mr Aleksandar Memčević**

*Aleksandar Memčević*



**Mali i Zi / Crna Gora**  
**Komuna e Tuzit / Opština Tuzi**

**Sekretariati për bujqësi, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe administrimin e ujërave**  
Sekretariat za poljoprivredu, zaštitu životne sredine i vodoprivredu

Nr./Br. 06-317/26-4691/11

**Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44**  
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167  
agrotuzi@tuzi.org.me

Tuz – Tuzi, 19.06.2026. godine

Në bazë të nenit 4 të Vendimit për nxitjen dhe investimet në zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Tuzit („Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 20/23), si dhe Programit të masave për realizimin e mjeteve për zhvillimin e prodhimit bujqësor në Komunën e Tuzit për vitin 2026 – Agrobuxheti („Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 26/26), Sekretariati për bujqësi, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe menaxhimin e ujërave shpall:

## **THIRRJE PUBLIKE** **PËR PAGESA DIREKTE NË PRODHIMTARINË BIMORE PËR VITIN 2026**

### **I. LLOJI I MBËSHTETJES**

Mbështetja u dedikohet prodhuesve bujqësorë nga territori i Komunës së Tuzit, të cilët veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në territorin e Komunës së Tuzit, përkatësisht bartësve të amvisërive bujqësore. Kjo masë realizohet përmes mbështetjes për njësi sipërfaqeje (ha), përkatësisht për sipërfaqet e punuara me kultura njëvjeçare, kultura shumëvjeçare, bimë dekorative dhe aromatike, perime dhe kultura arash.

### **II. VLERA MBËSHTETJES**

Vlera e mbështetjes do të varet nga mjetet financiare të planifikuara për këtë masë, si dhe nga sipërfaqet e mbjella me perime, kultura arash, kultura shumëvjeçare dhe bimë dekorative e aromatike.

Mbështetja do të jetë deri në 500,00 € për hektar të sipërfaqes së punuar, përkatësisht sipërfaqes së mbjellë me kultura njëvjeçare, kultura shumëvjeçare, bimë dekorative dhe aromatike, perime dhe kultura arash. Sipërfaqe e punuar konsiderohet toka arë e mbjellë me kulturë bujqësore në fushë të hapur, në serë ose me kultura shumëvjeçare. Mbështetja për hektarin e parë do të jetë deri në 500,00 €, ndërsa për çdo hektar pasues deri në 300,00 €/ha.

Shuma maksimale e mbështetjes për një amvisëri bujqësore është deri në 5.000,00 €.

Në rast se shuma totale e kërkesave të miratuara tejkalon fondet e planifikuara në buxhet, vlera e mbështetjes do të zvogëlohet në mënyrë proporcionale deri në nivelin e mjeteve të disponueshme. Për zbatimin e kësaj mase, me Agrobuxhet janë planifikuar mjete në shumën prej 295.500,00 €.

### **III. PËRFITUESIT E MBËSHTETJES**

Përfitues të mbështetjes sipas kësaj Thirrjeje Publike janë amvisëritë bujqësore dhe prodhuesit bujqësorë nga territori i Komunës së Tuzit, të cilët veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në territorin e komunës dhe që, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës, janë të regjistruar në:

- Regjistrin e Amvisërive Bujqësore, në përputhje me Ligjin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural („Fleta Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 34/14, 1/15, 30/17, 51/17 dhe 59/21) dhe Rregulloren për formën dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të Subjekteve dhe Regjistrin të Amvisërive Bujqësore („Fleta Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 16/14 dhe 37/18), të cilin e administron Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave, si dhe në regjistrin që mbahet nga Drejtoria për Sigurinë Ushqimore, Veterinarinë dhe Çështjet Fitosanitare; ose
- Regjistrin e Prodhuesve Primarë të Ushqimit me Origjinë Bimore, në përputhje me Ligjin për Sigurinë Ushqimore („Fleta Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 57/15); ose
- në rast se paraqitësi i kërkesës është person juridik, duhet të ketë si veprimtari kryesor veprimtarinë nga Sektori A – Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkataria, në përputhje me Ligjin për Klasifikimin e Veprimtarive („Fleta Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 18/11).

#### IV. PROCEDURA E ZBATIMIT DHE AKTIVITETET

Mbështetja sigurohet për të gjitha amvisëritë bujqësore për sipërfaqet e punuara, përkatësisht sipërfaqet me kultura njëvjeçare, kultura shumëvjeçare, bimë dekorative dhe aromatike, perime dhe kultura arash.

Aktivitetet për realizimin e kësaj mase janë:

- paraqitja e kërkesës në Sekretariat për përfitimin e mbështetjes për hektar për kulturat njëvjeçare, kulturat shumëvjeçare, bimët dekorative dhe aromatike, perimet dhe kulturat e arave për vitin 2026 (Formulari 1), së bashku me dokumentacionin përkatës;
- pranimi i kërkesave dhe dokumentacionit të nevojshëm;
- verifikimi dhe kontrolli në terren i prodhimit;
- shqyrtimi i kërkesave;
- realizimi i pagesës në llogarinë rrjedhëse të paraqitësit të kërkesës.

#### V. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Kërkesa e plotësuar për përfitimin e mbështetjes në prodhimtarinë bimore për vitin 2026 (pjesë përbërëse e kësaj Thirrjeje Publike);

- dëshmi për regjistrimin pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave;
- kërkesa për përfitimin e mbështetjes për pagesa direkte pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Menaxhimit të Ujërave (SIZEP);
- fotokopje e letërnjoftimit;
- fotokopje e xhirologarisë rrjedhëse bankare.

#### VI. MËNYRA E PARAQITJES SË KËRKESËS

Formulari i Kërkesës për përfitimin e mbështetjes në prodhimtarinë bimore për vitin 2026 (Shtojca I) mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e Komunës së Tuzit ([www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me)) ose të merret në ambientet e Sekretariatit për Bujqësi, Mbrojtjen e Mjedisit dhe Menaxhimin e Ujërave.

Kërkesa e plotësuar, së bashku me dokumentacionin përkatës, dorëzohet në Arkivin e Komunës së Tuzit. Informata shtesë mund të merren në numrat e telefonit 067/083-367, si dhe në adresën elektronike: [agrotuzi@tuzi.org.me](mailto:agrotuzi@tuzi.org.me).

**Thirrja Publike është e hapur nga 19 qershori 2026 deri më 28 gusht 2026.**

Shqyrtimi i kërkesave do të bëhet gjatë periudhës së vlefshmërisë së Thirrjes Publike, ndërsa pagesat do të realizohen pas përfundimit të saj, jo më vonë se fundi i vitit kalendarik.

#### VII. SHËNIME

Paraqitësi i kërkesës mban përgjegjësi të plotë për saktësinë e të dhënave dhe dokumentacionit të dorëzuar. Sekretariati për Bujqësi, Mbrojtjen e Mjedisit dhe Menaxhimin e Ujërave rezervon të drejtën që, para realizimit të pagesës, të kryejë verifikimin administrativ dhe kontrollin në terren të sipërfaqeve të deklaruara.

Në rast të konstatimit të parregullsive, deklarimit të pasaktë të të dhënave ose keqpërdorimit të kësaj mase mbështetëse, Sekretariati ka të drejtë të nxjerrë vendim me të cilin përfituesit do t'i mohohet e drejta për të ardhshme (2027–2028), përveç rasteve të forcës madhore.

Me forcë madhore nënkuptohen ngjarje natyrore ose veprime njerëzore të paparashikueshme dhe të pashmangshme, të cilat kanë shkaktuar dëme dhe për të cilat nuk mund t'i atribuohet përgjegjësi paraqitësit të kërkesës.

Nëse paraqitësi i kërkesës pengon ose pamundëson zhvillimin e kontrollit, ose ndikon në çfarëdo mënyre në kryerjen e tij, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesat e paplota ose ato të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.



**Mr. Aleksandar Memçević**

*(Handwritten signature)*

**CRKNA GORA – MALI I ZI**

Opština Tuzi – Komuna e Tuzit

Sekretarijat za poljoprivredu, zaštitu životne sredine I vodoprivredu - Sekretariati për  
Bujqësi, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe administrimin e ujërave

**KËRKESË PËR MBËSHTETJE TË PRODHIMTARISË BIMORE PËR VITIN 2026**

**OBRAZAC 1. ZAHTJEV ZA DODJELU PODRŠKE U BILJNOJ PROIZVODNJI ZA 2026. GODINU**

**I: TË DHËNAT MBI PARSHTRUESIN E KËRKESËS**

**I: PODACI O PODNOSIOCU ZAHTJEVA**

Bartësi i amvisërisë bujqësore (Parashtruesi i kërkesës) Nosilac poljoprivredog gazdinstva (Podnosilac zahtjeva)	
Adresa:	
Kontakt telefon/i:	
NUA/JMB:	
Numri i xhiro llogarisë/Broj žiro računa:	
ID numri i amvisërisë (NRA):/ ID broj gazdinstva (RPG):	

**II: TË DHËNAT MBI SIPERFAQET E PUNUARA.**

**II: PODACI O OBRADIVIM POVRŠINAMA.**

NR/ RB	Sipërfaqja / Pivršina
Parcela 1	
Parcela 2	
Parcela 3	
Parcela 4	
Parcela 5	
Ukupno/Gjitësej	

**Deklaratë:** Me përgjegjësi të plotë morale. Materiale dhe penale, deklaroj se të dhënat e shënuara në kërkesë janë të sakta.

**Izjava:** Pod moralnom, materijalnom i krivičnom odgovornošću tvrdim da su tačni podaci navedeni u zahtjevu.

Data/ datum:

Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës/ Potpis podnosioca zahtjeva

\_\_\_\_\_2026